



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për Zonat Ekonomike , Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2023 të miratojë këtë :

### PROPOZIM

#### VENDIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR  
VENDOSJE TË BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË ZK  
QYLAGË –FAZA E DYTË

I. Me këtë Vendim fillon procedura për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e dytë.

II.OBLIGOHET, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të shpallë Konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e dytë.

III. Forma e konkursit publik, të përgaditet konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

IV. Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit.

V. Parcelat kadastrale të cilat do të ipen në shfrytëzim në fazën e dytë janë si vijon:

| Nr. | Numri i njësisë kadastrale | Lloji i pronës                        | Zona Kadastrale | Sipërfaqja           |
|-----|----------------------------|---------------------------------------|-----------------|----------------------|
| 1.  | P-71409090-00476-4         | Pronë shoqërore e Komunës së Lipjanit | Qylagë          | 17698 m <sup>2</sup> |
| 2.  | P-71409090-00476-5         | Pronë shoqërore e Komunës së Lipjanit | Qylagë          | 9433 m <sup>2</sup>  |

VI. Pronat e paluajtshme që do tu ipet në shfrytëzim subjekteve ekonomike do të jetë në afat prej 99 viteve.

VII. Bizneset të cilat do të përzgjidhen konform procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore në tri (3) vitet e para nga dita e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas tri viteve do të paguajnë si në tabelën në vijim:

| Vitet e Operimit                                    | Çmimi m2 – Në vit | Çmimi për 1 Ha – Në vit |
|-----------------------------------------------------|-------------------|-------------------------|
| Në 3 (tri) vitet e para                             | 0.00 euro         | 00.00 euro              |
| Prej vitit të 4 (katërt) deri në vitin e 7 (shtatë) | 0.07 euro         | 700.00 euro             |
| Prej vitit të 8 (tetë) deri në vitin e 10 (dhjetë)  | 0.11 euro         | 1 100.00 euro           |
| Prej vitit të 11 (njëmbëdhjetë)                     | 0.125 euro        | 1 250.00 euro           |

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

### Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Zonat Ekonomike, Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe Statutit të Komunës.

Me Vendim të Kuvendit të Komunës 15Nr.313-34450 të datës 30.06.2016 është themeluar Zona Ekonomike në Qylagë . Me datë 18.05.2016, Ministria ka nxjerrë Vendimin nr. 2456 me të cilin i ka dhënë Pëlqimin Komunës së Lipjanit për themelimin e Zonës Ekonomike respektivisht parkut industrial në Qylagë të Lipjanit pastaj Komuna ka vazhduar procedurat tjera konform dispozitave ligjore.

Me këtë Propozim – Vendim po fillohet me procedurat për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë- dytë e parë konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit.

Faza e parë për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë ka përfunduar.

Gjatë kësaj faze janë shpallur përfitues tri biznese me gjithësejt 46926 m2 me sipërfaqe për shfrytëzim për implementimin e projekteve të tyre.

Nga arsyet e cekura dhe në pajtim me dispozitat ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 463/02-57138

Lipjan, Më 05.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NUMËRIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409090-00476-5

|                                                                                            |                               |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:                                      | 1743/2023                     |
| Data dhe koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:          | 27.09.2023 - 09:44            |
| Komuna / Opština / Municipality:                                                           | LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN     |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:                                       | Qyllagë / Cuculjaga / Qyllagë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN     |

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësise kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësise<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                      | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Pëshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------------------------|---------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-71409090-00476-5                                                        | PARCELË / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shoqërore /<br>Društvena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Rural                     | 9443                                   |                                 | 14.06.2022                                        | 05.07.2022                       |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|------------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| KRÇEVA                                         |                                             |                                             | 14.06.2022                                        | 05.07.2022                       |

A.2.1.LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja<br>Përfaqja<br>Area |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 1                       | Industri/Industrija/Industry                                                       | Repart prodhues/Proizvodni pogon/Production unit                                   |                                                       | 9443                           |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                       | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| Posedim individual /<br>Indivídualna Drzavina /<br>Single possessor | Komuna e Lipjanit   | 600371588                             | ///                                    |                                             | SHQIPËRIA                                                   | 1/1                                          |                                   | 17.06.2022                        |



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409090-00476-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1743/2023

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

27.09.2023 - 09:44

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Oylagë / Cuculljaga / Oylagë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësish kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësish<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type                      | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Urađeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------------------------|----------------------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------|
| P-71409090-00476-4                                                        | PARCELË / PARCELA<br>/ PARCEL                  | Pronë shoqërore /<br>Društvena<br>Imovina /<br>Socially owned<br>Land | Rural                     | 17698                                  |                                  | 14.06.2022                                       | 25.07.2023                       |

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Urađeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|------------------------------------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------|
| KRÇEVA                                         |                                             |                                             | 14.06.2022                                       | 25.07.2023                       |

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenuto koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|------------------------------------------|
| 1                       | Industri/Industrija/Industry                                                       | Repart prodhues/Proizvodni pogon/Production unit                                  |                                                       | 17698                                    |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights                                        | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojednosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo inovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|----------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| Posedim individual /<br>Individualna Druzavina /<br>Single possessor | Komuna e Lipjanit   | 600371588                             | / / /                                  |                                             | SHQIPËRIA                                                   | 1/1                                          |                                   | 17.06.2022                        |



эк Рыжѣ